



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorëzuar Punë/Prodato Received/Delivered	31. 12. 2021	viti god year	
Organ /Rjeshta Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Ri Prot Prot No	Shtojca Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	6484/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.993/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti- anëtarë, si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.993/2021 të datës 01.12.2021, të parashtruar nga ankuesit dhe kundër organit të punësimit Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.993/2021 e datës 01.12.2021 e parashtruar nga ankuesit dhe

A r s y e t i m

Ankuesit, të punësuar në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës (tutje AKK), me datë 01.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër përgjigjes refuzuese të datës 19.11.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKK-së.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 14.12.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Autoriteti Kosovar i Konkurrencës. Ndërsa më datë 23.12.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot: 5754/2021 të datës 01.12.2021 e parashtruar nga grup ankuesish në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.12.2021; E-mailin nga A.GJ. për S.I. të datës 19.11.2021; E-mailin nga S.I. për A.GJ. të datës 19.11.2021; E-mail nga S.I. për A.T. të datës 16.11.2021; E-mail nga A.GJ. për S.I. të datës 15.11.2021; Kërkesën për mbulimin e shpenzimeve për ngritje profesionale – master programi për Udhëheqësit e Divizioneve të AKK-së të datës 16.11.2021; Përgjigjen në kërkesën për mbulimin e shpenzimeve për ngritje profesionale Master programi për Udhëheqësit e Divizioneve të AKK-së i datës 16.11.2021; Vendimin nr. 21/21 i datës 30.04.2021; E-mailin nga E.T. për A.GJ. i datës 01.12.2021; E-mailin A.GJ. për E.T. i datës 01.12.2021; E-mailin nga R.A. për A.GJ. i datës 01.12.2021; E-mailin nga S.B. për A.GJ. i datës 01.12.2021; Përgjigje në ankesë e datës 23.12.2021; Akt Emërimit e A.GJ. i datës 07.12.2018; Përshkrimin e Detyrave të Punës i datës 31.01.2018; Diplomën me Nr.2485 të datës 22.03.2011; Akt Emërimit R.A. të datës 07.12.2018; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 31.01.2018; Diplomën me Nr. 1792 të datës 20.06.2008; Akt Emërimit e S.B. të datës 07.12.2018; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 31.01.2018; Diplomën me Nr.1105 të datës 08.06.2005; Akt Emërimit e E.T. të datës 07.12.2018; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 31.01.2018; Diplomën me Nr. 1373 të datës 31.01.2006; E-mailin nga A.GJ. për S.I. të datës 15.11.2021; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 6298/2021 të datës 23.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, konstatoi se është e pabazuar ankesa e ankuesve

Ihe

shkresë:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, është konstatuar se ankuesit që të gjitha janë të punësuar si nëpunës civilë në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, ashtu që sipas Akt Emërimit me numër protokollit 432/18-04/B të datës 07.12.2018, është i emëruar në pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit të Përqendrimeve-Bashkimeve, ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokollit 430/18-04/B të datës 07.12.2018, është i emëruar në pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit të Pozitës Dominuese, sipas Akt Emërimit me numër protokollit 431/18-04/B të datës 07.12.2018, është i emëruar në pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit të Marrëveshjeve të Ndaluar, ndërsa ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokollit 433/18-04/B të datës 07.12.2018, është i emëruar në pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit të Analizës, Metodologjisë dhe të Drejtave Ekskluzive.

Ankuesit me datë 16.11.2021, përmes shkresës me numër protokollit 295/21-08/B i janë drejtuar me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm të AKK-së, me kërkesën për mbulimin e shpenzimeve për ngritje profesionale–master programi për Udhëheqësit e Divizioneve të AKK-së pranë Universitetit UBT në Prishtinë, me arsyen se të njëjtët nuk mund të vazhdojnë këto studime me të ardhurat e tyre vetanake.

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës me datë 19.11.2021, nëpërmjet E-mailit zyrtar ka njoftuar ankuesit se “ në mungesë të Komisionit të AKK-së, për të marrë vendime meritore lidhur me kërkesën tuaj, ju informoj se në momentin që do të filloj Kamioni i Ri, e paraqes për miratim në mbledhjen e Komisionit. Vendimi Nr.21/21 i datës 30.04.2021 ka përcaktuar dy fusha të edukimit profesional që kompensohen nga AKK, ndërsa studimet master nuk i mbulon ky vendim, edhe pse shumë të vlefshme dhe me interes për Juve personalisht dhe për Institucionin.. Kërkesën tuaj e ka

diskutuar edhe më përfaqësuesit e Projektit që mbështet AKK-në, për të cilën nuk ka marrë përgjigje pozitive (nuk është në termat e projektit)."

Kundër përgjigjes së Drejtorit të Përgjithshëm të AKK-së të datës 19.11.2021, ankuesit brenda afatit ligjor ushtrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se kërkesa e tyre për avancim dhe aftësim profesional bazohet në nenin 23 dhe 31 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesve, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik konkretisht nenin 23 me të cilit është përcaktuar se *"Nëpunësit civilë kanë të drejtën të përmirësojnë aftësitë profesionale për vendin e punës nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme të financuara nga fondet publike, nga donatorë të huaj apo nga të ardhurat vetanake, si dhe nenin 31 paragrafi 2 po të këtij ligji ku parashihet se:* 2. *Nëpunësi civil ka obligimin të përmirësojë aftësitë profesionale nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme të financuara nga fondet publike..."* dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjor, Kolegji konstatoi se nëpunësit civilë kanë të drejtën e aftësimit të vazhdueshëm profesional përmes trajnimeve apo programeve profesionale nga fusha e kompetencave dhe përgjegjësi të punës, ndërsa institucioni bartë detyrimin e financimit gjegjësisht kompensimit të shpenzimeve të trajnime në fjalë. Andaj, mbi këtë bazë dhe duke marrë parasysh faktin se kërkesa e ankuesve ka të bëjë me kompensimin e shpenzimeve për studime post diplomike, e jo për trajnime të vazhdueshme profesionale, Kolegji vlerëson se janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesve si në pikën 1 të dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në mbledhjen e mbajtur me datës 30.04.201 ka nxjerrë Vendimin Nr.21/21, për kompensimin e shpenzimeve për ngritje profesionale të stafit të AKK-së, të cilët përfundojnë me sukses Edukimin e Vazhdueshëm Profesional në fushat profesionale të Jurisprudencës dhe Kontabilitetit (Teknik i kontabilitetit dhe Kontabilist i certifikuar), kështu që, Kolegji bazuar në rrethanat e konstatuara si me lartë vlerëson se Drejtori i Përgjithshëm i AKK, me rastin e refuzimit të kërkesës së ankuesit përmes përgjigjes së datës 19.11.2021 mbi bazën se Vendimi Nr.21/21 i datës 30.04.2021 nuk mbulon studimet master, ka vepruar në pajtim me dispozitat materiale ligjore si me lartë.

Andaj, bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.993/2021

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka
Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesve; dhe
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
- Udhëheqësit të Personelit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

